

35665

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANË**

Nr. \_\_\_\_\_ **VENDIMIT**

**V E N D I M**  
**PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Sot me datë 5/5 / 2006, unë Gjyqtarja e Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë, R. Poljoch, pasi shqyrtova kërkesën e kërkuarit Kastriot Reçi për të kryer të gjitha veprimet e duhura prane Gjykatës Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë, për regjistrimin si person juridik të shoqërisë tregtare "REÇI KGM" sh.p.k, shoqëri në formim e sipër

**K O N S T A T O V A**

Se kërkuari, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "REÇI KGM" sh.p.k shoqëri në formim e sipër, ka kërkuar regjistrimin e kësaj shoqërie në regjistrin tregtar, në përputhje me nenin 19 te ligjit 7632 datë 29/04/1991 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar".

Shoqëria "REÇI KGM" sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjet, me seli në qytetin e Rreshenit ne Rr. "At Gjergj Fishta" Pallati i Kultures, me objekt veprimtarie:

Veprimtarinë radiotelevizive, që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Themelues të shoqërisë janë z. Kastriot Reçi, i pajisur me pasaportën nr Z1741720, lindur dhe banues në Rreshen, i cili zotëron 40%(dyzet përqind) të kuotave të kapitalit themeltar, z.Gasper Reçi i pajisur me pasaportën nr Z0493575, lindur dhe banues në Rreshen, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar dhe z.Martin Reçi lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0208069, lindur dhe banues në Rreshen, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000(njëqind mije) lekë.

Në detyrën e administratorit për një afat të pacaktuar caktohet z. Kastriot Reçi i datëlindjes 18 maj 1972.

Konkresa është ne pajtim me ligji dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992, Per Shoqerite Tregtare dhe te ligjit 7667, date 28.01.1993, Per Rregjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare.

### V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik privat te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "REÇI KGM" sh.p.k. me kapital themeltar 100.000(njeqind mije) leke, me seli ne qytetin e Rreshenit, ne Rr. " At Gjergj Fishta" ,Pallati I Kulture, me objekt veprimtarie:

Veprimtari radiotelevizive qe perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji, me ane te zerit figures, sinjaleve te koduara, shkrimit , te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter per nje kohezgjatje 10-vjecare, me ortake Kastriot Reçi, zoterues I 40% (dyzete perqind) te kuotave te kapitalit themeltar, me Gasper Reçi, zoterues I 30% te kapitalit themeltar dhe me Martin Reçi, zoterues I 30% te kapitalit themeltar, me administrator te saj Kastriot Reçi.

Shoqeria do te filloje aktivitetin ne fushen e objektit te saj, pasi te pajiset me leje a license nga organi administrativ kompetent Keshilli Kombetar I Radiotelevizioneve, konform ligjit Nr 8410, date 30.09.1998 dhe ndryshimeve te mevonshme te tij.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

G J Y Q T A R J A

*Legjislative Assembly*  
*2006*

URDHER RREGJISTRIMI

35665

Emertimi:

4  
REÇI KGM s.p.a.

Selia:

Adresa Rr. At Gëgjë Fierë (Pall kulturës)

Objekti:

Qendër Televizion lokal.

Kapitali:

te dorëzuar. Rrethorë Bani. 04/15/2006  
100% Rrethorë dhe

Mandat Arketimi:

100.000 (te punë me seli)

Administrator i shoqërisë:

Kostes Rezi i Bani i Kollon  
04/11/2006 Bani me Rrethorë.

Ortakët:

1) Kostes Rezi 40%  
2) Gëgjë Rezi 30%  
3) Bani Rezi 30%

Kohezgjatja:

04/11/2016

Statuti i nënshkruar ne dt:

18-04-2006 (nënk. Vije Bani  
Mrethorë)

Nr fleteve Akt themelimi:

3 flete me 1165/313 dt  
19/04-2006 Vije Bani

Nr fleteve Statuti:

9 flete me 1167/324 dt 18-04-2006

Rregjistruar ne dt:

5-5-2006

Shenime:

Nënk. Bani

GJYQTARE



## **AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISË “REÇI KGM” SH.P.K**

### **Neni 1 Emërtimi**

Në bazë të Ligjit Nr 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “REÇI KGM”, Sh.p.k. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe aktiviteti i saj kryhet sipas ligjeve shqiptare, sipas kësaj kontrate dhe Statutit bashkëngjitur.

### **Neni 2 Selia**

Shoqëria e ka selinë në qytetin e Rreshenit në Rr. “At Gjergj Fishta” Pallati i Kultures.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**


Kohëzgjatja e Shoqërisë është të jetë 10 (dhjetë) vjet duke filluar nga data e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tiranë, deri në 2016 dhe ky afat mund të shkurtrohet ose të zgjatet me vendim të Asamblesë së Ortakëve

### **Neni 4 Ortakët**

Shoqëria themelohet nga ortakët :

1. Kastriot Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 18 maj 1972 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z1741720, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 40%(dyzet përqind) të kuotave të kapitalit themeltar:

2. Gasper Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 20 nëntor 1974 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0493575, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar



3. Martin Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 09 korrik 1965 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0208069, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar

Në Pëputhje me Ligjin “Për Shoqëritë Tregtare” në Shoqëri mund të përfshihen dhe ortakë të tjerë m, të cilët bëhen zotërues të pjesëve të caktuara të kapitalit.

### **Neni 5 Objekti**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :  
Veprimtarinë radiotelevizive , që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të cdo lloj me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike ,kablove, përsëritsve, satelitëve apo me cdo mjet tjetër.

### **Neni 6 Kapitali**

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000(njëqindmijë) lek i ndarë në kuota me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lek secila.

### **Neni 7 Kuotat e pjesëmarrjes**

Kuotat e pjesëmarrjes janë në zotërim të z. Kastriot Reçi në masën 40% të kapitalit themeltar, të z. Gasper Reçi ,në masën 30% te kapitalit themeltar dhe te z. Martin Reçi në masën 30% te kapitalit themeltar

### **Neni 8**

Viti ekonomik mbyllet në 31 Dhjetor të cdo viti dhe bilanci duhet të miratohet brënda tre nuajve që vijojnë. Viti i parë ekonomik mbyllet me 31 Dhjetor 2003.

### **Neni 9**

Në detyrën e administratorit të shoqërisë për një afat të përcaktuar caktohet z Kastriot Reçi





### Neni 10

Të gjitha mosmarrëveshjet me të tretët në lidhje me ekzekutimin e normave të këtij akti do të zgjidhen në marrëveshje midis palëve. Në rast të kundërt do t'ju referohet normave juridike në fuqi dhe organeve kompetente.

### Neni 11


Ky akt është reduktuar në 4 (kater) kopje origjinale.

## ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Kastriot REÇI

Gaspar REÇI

Martin REÇI





# STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “REÇI KGM” SH.P.K

## KAPITULLI 1 EMËRTIMI-OBJEKTI SELIA-KOHËZGJATJA

### NENI -1 EMËRTIMI

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “REÇI KGM” sh.p.k (Më poshtë referuar si “Shoqëria”)

Shoqëria është person juridik shqiptar sipas ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “Mbi shoqëritë tregtare”.

Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar që prej datës në të cilën organet kompetente kanë dhënë aprovimin për themelimin e saj.

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese (akt themelimi dhe statut).

### NENI -2 SELIA

Shoqëria e ka selinë në Rreshen në Rr. “At Gjergj Fishta” Pallati i Kultures. Përveç veprimtarisë që zhvillohet në nivel lokal, për aktivitetin tjetër Asambleja ka të drejten e krijimit dhe të shuarjes së selive dytësore, filiale, agjensi dhe zyra përfaqësimi pa kufizim territorial.

### NENI -3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat 10 vjeçar. Me vendimin e asamblesë të ortakëve, në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj.

### NENI -4 OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Veprimtarinë radiotelevizive, që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nepërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

## **NENI -5 ORTAKËT**

Shoqëria themelohet nga ortakët :

1. Kastriot Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 18 maj 1972 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z1741720, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 40%(dyzet përqind) të kuotave të kapitalit themeltar.

2. Gasper Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 20 nentor 1974 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0493575, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar.

3. Martin Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 09 korrik 1965 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0208069, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar.  
Në Pëputhje me Ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" në Shoqëri mund të përfshihen dhe ortakë të tjerë m,të cilët bëhen zotërues të pjesëve të caktuara të kapitalit.

## **KAPITULLI 2**

### **KAPITALI DHE KUOTAT**

#### **NENI -6 KAPITALI**

Kapitali është fiksuar në lek 100.000. Ai mund të rritet me vendim të asamblese sipas normave të fushës në fuqi dhe ndalet në kuota prej 1.000 lek secila.

#### **NENI -7**

Kuotat janë nominative dhe nuk mundet asnjëherë të prezantohen nga letra me vlerë, në zbatim të nenit 44 të ligjit 7638/92.

Kapitali i shoqërisë ndahet midis ortakëve në këtë mënyrë:

1. Z.Kastriot Reçi i cili kontribon 40 000(dyzet mijë) lek, duke u bërë zotërues i 40 % (dyzet përqind) të kapitalit themeltar ,dhe konkretisht zotëron 40, kuota të kapitalit themeltar shoqërisë;

2. Z.Gasper Reçi i cili kontribon 30 000(tridhjetë mijë) lek, duke u bërë zotërues i 30 % (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar ,dhe konkretisht zotëron 30, kuota të kapitalit themeltar shoqërisë;

3. Z.Martin Reçi i cili kontribon 30 000(tridhjetë mijë) lek, duke u bërë zotërues i 30 % (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar ,dhe konkretisht zotëron 30, kuota të kapitalit themeltar shoqërisë.

Sidoqoftë çdo ortak mundet të marrë nga shoqëria një vërtetim që të vërtetojë cilësinë e tij si ortak dhe vlerën e kuotës të zotëruar nga ai.



## **NENI -8 PARABLERJA**

Ortaku që synon të shesë kuotat e tij, duhet të informojë me letër rekomande organin administrativ, i cili ua komunikon ortakëve të tjerë.

Këta mund të bëhen blerës të kuotave të ofruara për shitje në raport me kuotat që zotërojnë, në mënyrë që të lihet i pandryshueshëm kapitali themeltar ekzistues.

Brenda tre muajve nga dita e dhënies së komunikimit, ortakët duhet ti komunikojnë organit administrativ nëse dëshirojnë të blejnë.

Në rast se nuk e bëjnë një komunikim të tillë në afatin e treguar më sipër, konsiderohet se kanë hequr dorë.

Në një rast të tillë kuota e ofruar për shitje mund të blihet nga ortaku ose nga ortakët që kanë komunikuar brenda afatit dëshirën për të blerë.

Nëse asnjëri nga ortakët nuk e ushtron të drejtën e parablerjes sipas modaliteteve të përcaktuara më sipër, kuotat janë lirisht të disponueshme.

E drejta e parablerjes nuk zbatohet në rastet kur shitja është bërë në favor të bashkëshortit ose të të afërmeve në vijë të drejtë.

## **NENI -9**

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial. Shoqëria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo vijnë në dijeni.

## **NENI -10**

Ortakët kanë të drejten e informimit mbi aktivitetin e shoqërisë.

## **NENI -11**

Për rritjen e kapitalit themeltar, në rastet e parashikuara nga ligji, asamblea vendos me votën pro të aq ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit themeltar.

## **NENI - 12**

Derdhjet përkatëse në kuotat e shoqërisë kërkohen nga organi administrativ në afatet dhe në mënyrat që ai vetë do t'i vendosë si të përshtatshme, duke përcaktuar penaltitetet përkatëse dhe sanksionet për vonese.

## **KAPITULLI III**

### **ASAMBLETE**

#### **NENI - 13**

Asamblea rregullisht e thirrur përfaqëson tërësinë e ortakëve dhe vendimet e saj, të marra sipas ligjit dhe sipas këtij statuti, detyrojnë të gjithë ortakët.

#### **NENI - 14**

Asamblea e ortakëve mund të thirret të pakten një herë në vit, në selinë e shoqërisë ose në vendin e treguar në lajmërimin e mbledhjes.



### NENI – 15

Organi administrativ është i detyruar të thërrasë pa vonesë asamblenë e ortakëve, sa herë që aq ortakë që përfaqësojnë të paktën 10 % të kapitalit themeltar e kërkojnë, ose sa herë që vetë organi administrativ e cilëson të nëvojshme.

### NENI -16

Çdo ortak që ka të drejtën e pjesëmarrjes në asamble mund të përfaqësohet edhe nga një person jo ortak. Përfaqësimi, i cili mund të jepet vetëm për një asamble apo me efekt edhe për thirrje të mëtejshme, duhet të jepet me shkrim dhe dokumentat përkatëse duhet të ruhen pranë selisë së shoqërisë.

### NENI – 17

Delegimi për të marrë pjesë në asamblenë e ortakëve nuk mund të lëshohet pa shkruar emrin e përfaqësuesit.

Përfaqësuesi mundet të zëvendësohet vetëm nga personi shprehimisht dhe paraprakisht i treguar në delegim.

Entet ose shoqëritë e themeluara në bazë të ligjit mund të marrin pjesë në asamble nga personi i shënuar në delegimin e shkruar.

I përket drejtuesit të asamblesë të konstatojë rregullshmërinë e delegimeve dhe në përgjithësi të drejtën e marrjes pjesë në asamble.

### NENI – 18

Drejtimi i asamblesë, sipas sistemit të administrimit i takon:

- administratorit të vetëm;
- administratorit më të vjetër ose administratorit prezent në rastin e dy administratorëve;

Ne rastet se as njëri as tjetri nuk dëshirojnë të ushtrojnë një rol të tillë atëherë pjesëmarrësit me votat pro që përfaqësojnë shumicën për nga kapitali, mund të zgjedhin një drejtues nga rradhët e tyre .

### NENI – 19

Thirrjet e asamblesë duhet të bëhen nën kujdesin e organit administrativ, me letër rekomande që ju dërgohet ortakëve të paktën pesëmbëdhjet ditë përpara mbledhjes. Në letër duhet të përcaktohet vendi, dita, ora dhe rendi i ditës.

Asamblea mund të quhet vlefshëmrisht e mbledhur edhe sipas nenit 57 të ligjit 7638/92 dhe në rast se mungojnë formalitetet e përcaktuara në nenin e mëparshëm, pra kur përfaqësohet i gjithë kapitali themeltar.

### NENI – 20

Vendimet e asamblesë mund të shkruhen në proces-verbal. Asamblea emëron një sekretar qoftë ose jo ortak dhe nëse e quan të arsyeshme dy persona për numërimin e votave që mund të jenë edhe të jashtëm.

Vendimet e asamblesë duhet të shkruhen në proces-verbal të firmosur nga drejtuesi i mbledhjes, nga sekretari dhe nëse janë edhe numëruesit e votave.

### **NENI – 21**

Vendimet e asamblesë merren me votim të hapur.

### **NENI - 22**

Asamblea e ortakëve vendos me votën pro të atë ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitullit themeltar.

### **NENI – 23**

Ne rastet e ndryshimeve të statutit, asamblea vendos rregullisht, me votën pro të atë ortakëve që përfaqësojnë të paktën 2/3 e kapitalit themeltar.

## **KAPITULLI IV**

### **ADMINISTRIMI**

#### **NENI – 24**

Shoqëria administrohet sipas emërimit të aktit të themelimit ose të asamblesë së zakonshme:

- nga një administrator i vetëm;
- nga dy administrator që veprojnë bashkarisht ose më vete;

Asamblea zgjedh sistemin e administrimit vendos për numrin e anëtarëve.

#### **NENI – 25**

Administratori i jep ortakëve të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me shoqërinë, sa herë që kjo kërkohet nga ata.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën dhjetë për qind të kapitalit të shoqërisë kanë të drejtë midis të tjerave, të kërkojnë kontrollin e drejtimit, me shpenzimet e tyre.

#### **NENI – 26**

Nëse shoqëria administrohet nga një këshill administriv, atëherë me shumice votash, zgjidhet përfaqësia e këshillit, e përbërë nga dy anëtarë, të cilët ushtrojnë bashkarisht kompetencat e administratorëve sipas përcaktimit të nenit 50 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992.

#### **NENI – 27**

Keshilli administrativ mblidhet në vendin që përcaktohet në lajmërimin e mbledhjes, si pranë selisë së shoqërisë ashtu edhe gjetkë.

Keshilli administrativ thirret me komunikim me shkrim për çdo administrator, sa herë që përfaqësuesi i Keshillit e gjykon të nevojshme ose kur bëhet kërkesë nga shumica e administratorëve në detyrë.



Thirrja bëhet të paktën pesë ditë përpara. Në rast urgjence afati mund të jetë edhe më i shkurtër, por sidoqoftë jo më pak se dhjetë ditë.

#### **NENI – 28**

Mbledhjet e këshillit administrativ drejtohen nga përfaqësuesi i këshillit ose nga anëtari i këshillit që caktohet nga vetë këshilli.

#### **NENI-29**

Për vlefshmërinë e vendimeve të këshillit është nevojshme prezenca e shumicës së administratorëve në detyrë.

Vendimet merren me shumicën absolute të personave prezent dhe në rast të ndarjes së votave në mënyrë të barabartë, vlen vota e përfaqësuesit të këshillit.

#### **NENI-30**

Vendimet e këshillit administrativ duhet të shkruhen në proces-verbal që firmoset nga të gjithë personat prezent.

#### **NENI-31**

Organi administrativ i ka të gjitha të drejtat për drejtimin zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa asnjë kufizim dhe ka të drejtën të kryejë të gjitha detyrat që do t'i quajë të nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë, duke bërë përjashtim për ata që në mënyrë taksative ligji ja rezervon asmblesë ose që i ndalohen nga normat e këtij statuti.

### **KAPITULLI V**

### **FIRMA DHE PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË**

#### **NENI 32**

Përfaqësimi i shoqërisë i takon organit administrativ të zgjedhur nga ortakët sipas nenit 50të ligjit 7638, datë 19.11.1992. Targat e përfaqësimit ushtrohen në kufijtë e përcaktuar në statut .

#### **NENI-33**

Organi administrativ ka gjithashtu fuqinë për të emëruar drejtorë, teknikë, përfaqësues për mosmarrëveshje dhe në përgjithësi të autorizuar për detyra të përcaktuara ose për kategori detyrash, edhe me të drejtën e delegimit ,duke caktuar për secilin nga këto ato detyra shpërblime ose pjemarrje në fitime që i vlerëson të arsyeshme.

Për fusha të veçanta të objektit të veprimtarisë së shoqërisë, organi administrativ mund të emërojë borde drejtuese ose drejtorë. Në aktin e emërimit vendosen kompetencat dhe format e shpërblimit. Në rastin e emërimit të bordeve drejtuese, asamblea e ortakëve, me propozimin e organit administrativ miraton rregulloret e funksionimit të tyre.



## KAPITULLI VI

### EKSPERTET KONTABËL TË AUTORIZUAR

#### NENI-34

Shoqëria do të jetë e kontrolluar nga një organ i përbërë nga një deri në tre ekspertë kontabël të autorizuar, që emërohen dhe funksionojnë sipas normave të nenit 69 të ligjit 7638/92

Asamblea e ortakëve kujdeset të emërojë ekspertët kontabël të autorizuar.

#### NENI-35

Ekspertët kontabël të autorizuar e mbajnë këtë detyrë gjashtë vjet dhe janë të rizgjedhshëm.

#### NENI-36

Asamblea në emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar përcakton shpërblimet në rast se këto nuk janë përcaktuar në ndonjë akt ligjor

## KAPITULLI VII

### BILANCI DHE TË ARDHURAT

#### NENI – 37

Veprimtaritë ekonomike të shoqërisë mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti.

#### NENI – 38

Në fund të çdo veprimtarie organi administrativ, brenda tre muajve duhet të procedojë në përgatitjet e bilancit të shoqërisë të përbërë nga gjendja e pronësisë dhe nga llogaria ekonomike.

#### NENI – 39

Bilanci duhet të shoqërohet nga një relacion i organit administrativ që bën të qartë si ecurinë e administrimit në sektorë të ndryshëm në të cilët shoqëria ka vepruar, edhe me shoqëritë e tjera që kontrollohen prej saj, me një kujdes të veçantë si për investimet, për kostot dhe për çmimet ashtu edhe për faktet me rëndësi që janë vërtetuar pas mbylljes së veprimtarisë.

#### NENI – 40

Bilanci dhe relacioni i administratorëve duhet të mbeten të depozituar pranë selisë së shoqërisë 15 ditë para mbledhjes së asamblesë së ortakëve, që thirret për t'i aprovuar ato, gjatë së cilës ortakët mund të kërkojnë e të shqyrtojnë kopje me shpenzimet e tyre. Këto dokumenta duhet të jenë në dispozicion të ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se janë të emëruar, të paktën 40 ditë para mbledhjes së asamblesë që duhet ti aprovojë.

#### **NENI – 41**

Të ardhurat neto, pasi lihen mënjatë jo më pak se 5% për rezervën e nevojshme, e cila nuk duhet të kalojë 20% të kapitalit themeltar duhet t'u shpërndahen ortakëve, përjashtojt rastin kur asambleja vendos për shpenzime të veçanta.

#### **NENI – 42**

Pagesa e të ardhurave duhet të bëhet pranë arkës në selinë e shoqërisë duke hyrë në fuqi nga data e caktuar nga asambleja e ortakëve që ka vendosur shpërndarjen e tyre.

Në mungesë të përcaktimit të datës fillimit të pagesës së të ardhurave, këto do të jenë në dispozicion të shoqërisë duke nisur nga dita e 30 nga data e vendimit të shpërndarjes së të ardhurave ortakë.

#### **NENI – 43**

Të ardhurat që nuk janë tërhequr brenda pesë vjetëve duke filluar nga dita që janë bërë të zbatueshëm parashkruhen në fondin e shoqërisë dhe kalojnë në fondin rezervë.

### **KAPITULLI VIII**

## **SHUARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

#### **NENI – 44**

Rastet e prishjes së shoqërisë janë:

- a) Kalimi i afatit,
- b) Arritja e qëllimit të shoqërisë ose pamundësia për të arritur atë,
- c) Pamundësia e funksionimit ose vazhdimi inaktiv i asamblesë,
- d) Rastet e tjera të parashikuara në nenin 38 e 72 të ligjit 7638/92 që kanë të bëjnë me ndryshimin e shoqërisë në një formë tjetër për shkak të zvogëlimit të kapitalit në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar si vlerë minimale për kapitalet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, ose që kanë të bëjnë me zgjidhjen e parakoshme për shkak të humbjes së gjysmës së kapitalit themeltar.

#### **NENI – 45**

Vendosja në likuidim e shoqërisë përcaktohet nga mbledhja e asamblesë së ortakëve, e cila kontrollon dhe miraton përfundimisht procedurat e likuidimit dhe mbylljen e shoqërisë.

#### **NENI – 46**

Me emërimin e likuidatorit ose të likuidatorëve pushojnë funksionet e organit administrativ.

#### **NENI – 47**

Likuiduesi ose likuiduesit, emërohen me vendim të asamblesë së ortakëve të marrë me votën pro të shumicës së kapitalit themeltar.



#### **NENI – 48**

Likuiduesi ose likuiduesit, brenda gjashtë muajve nga data e emërimit të tij thërret mbledhjen e asamblesë së ortakëve, të cilës i paraqet raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, para se të fillojë operacionin e likuidimit.

#### **NENI – 49**

Likuiduesi përfaqëson shoqërinë dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për likuidimin e aktivitetit dhe të pasivitetit të saj.

Është i autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët dhe t'ju shpërndajë ortakëve tepricën në dispozicion.

#### **NENI – 50**

Shpërndarja e aktivitetit që tepron pas pagimit të ortakëve të kuotave që zotërojnë nga kapitali themeltar bëhet ndërmjet ortakëve në përpjestim të drejtë me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

### **KAPITULLI IX**

#### **DISPOZITA TË TJERA**

#### **NENI – 51**


Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

#### **NENI – 52**

Për ato që nuk janë shprehur në këtë status do të bëhet referim me dispozitat e ligjit në fuqi.

Ky status është hartuar në katër kopje origjinale.

Kastriot REÇI



Gaspar REÇI



Martin REÇI





*J. R. Kenaj*  
25 PRR NR. 2006/06

### KERKESE

**KËRKUES:**

**"KGM-GROUP"** sh.p.k një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në themelim e sipër me seli në qytetin e Rreshenit ne Rr. "At Gjergj Fishta" Pallati i Kultures. Përfaqësuar nga z.Kastriot Reçi , i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 18 maj 1972 lindur dhe banues në Rreshen ne cilësinë e administratorit të shoqërisë

**OBJEKTI:**

Kërkohet regjistrimi si person juridik i Shoqërisë me pergjegjesi të kufizuar "KGM-GROUP" sh.p.k.

**BAZA LIGJORE:**

Ligjet Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Për Shoqëritë tregtare" dhe Nr. 7667, dt. 29.01.1993 "Për Regjistrin tregtar".

*Coef. regjistruar në...*

### PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

*Shoqëria ka ortak të saj:*

Unë kërkuesi Kastriot Reçi, po i drejtohem Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me këtë kërkesë për të kërkuar regjistrimin si person juridik të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KGM-GROUP" sh.p.k.

*Regjistruar në...*

Shoqëria ka ortak të saj :

1. Kastriot Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 18 maj 1972 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z1741720, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 40%(dyzet përqind) të kuotave të kapitalit themeltar:


*U regjistruar...*

2. Gasper Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 20 nentor 1974 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0493575, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar

*Coef. regjistruar...*

3. Martin Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 09 korrik 1965 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0208069, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar

*Regjistruar...*







Selia e Shoqërisë është në qytetin e Rreshenit ne Rr. "At Gjergj Fishta"  
Pallati i Kultures.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 lekë.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë 10 vjet, duke filluar nga  
koha e regjistrimit tregtar deri në vitin 2016

Detyrën e administratorit të shoqërisë caktohet ta kryej ortakut i shoqërisë  
Z.Kastriot Reçi, për një kohëzgjatje të pacaktuar.

Shoqëria ka për objekt te veprimtarisë së saj:

Veprimtarinë radiotelevizive, që përfshin prodhimin, transmetimin dhe  
ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të  
zërit, figurës, sinjaleve të koduara,shkrimit, të destinuara për publikun  
nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove përsëritësve, satelitëve apo  
me çdo mjet tjetër.

Duke qenë se Shoqëria e krijuar plotëson të gjitha kushtet e nevojshme  
për zhvillim normal të veprimtarisë së saj dhe i përgjigjet kushteve të  
parashikuara nga legjislacioni në fuqi shpresojmë se Gjykata do të pranojë  
kërkesën e mësipërme.

**Me Respekt**

**Administratori**

**Kastriot REÇI**

**Rreshen me 19/04/2006**

## KERKESE

**KËRKUES:** "REÇI KGM" sh.p.k një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në themelim e sipër me seli në qytetin e Rreshenit ne Rr. "At Gjergj Fishta" Pallati i Kultures.  
Përfaqësuar nga z.Kastriot Reçi , i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 18 maj 1972 lindur dhe banues në Rreshen ne cilësinë e administratorit të shoqërisë

**OBJEKTI:** Kërkohej regjistrimi si person juridik i Shoqërisë me pergjegjesi të kufizuar "REÇI KGM" sh.p.k.

**BAZA LIGJORE:** Ligjet Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Për Shoqëritë tregtare" dhe Nr. 7667, dt. 29.01.1999 "Për Regjistrin tregtar".

### PËRPARA GJYKATËS SË RRETHIT GJYQESOR TIRANË

Unë kërkuesi Kastriot Reçi, po i drejtohem Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë me këtë kërkesë për të kërkuar regjistrimin si person juridik të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "REÇI KGM" sh.p.k.

Shoqëria ka ortak të saj :

1. Kastriot Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 18 maj 1972 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z1741720, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 40%(dyzet përqind) të kuotave të kapitalit themeltar:

2. Gasper Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 20 nëntor 1974 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0493575, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar

3. Martin Reçi i biri i Nikollit dhe i Gjeles i ditëlindjes 09 korrik 1965 lindur dhe banues në Rreshen i pajisur me pasaportën nr Z0208069, madhor në zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 30%(tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar

Selia e Shoqërisë është në qytetin e Rreshenit ne Rr. "At Gjergj Fishta" Pallati i Kultures.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 lekë.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë 10 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit tregtar deri në vitin 2016

Detyrën e administratorit të shoqërisë caktohet ta kryej ortaku i shoqërisë Z.Kastriot Reçi, për nje kohëzgjatje të pacaktuar.

Shoqëria ka për objekt te veprimtarisë së saj:

Veprimtarinë radiotelevizive, që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara,shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablove përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Duke qenë se Shoqëria e krijuar plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillim normal të veprimtarisë së saj dhe i përgjigjet kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi shpresojmë se Gjykata do të pranojë kërkesën e mësipërme.

**Me Respekt**

**Administratori**

**Kastriot REÇI**



**Rreshen me 19/04/2006**